



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

LISTË VERIFIKIMI PËR "Inspektim i institucioneve arsimore publike parauniversitare (IAP), për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimorë në institucionet e arsimit parauniversitar"

Nr.

Datë:

Qarku:

Subjekt i inspektuar për herë të:

1. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME TË SUBJEKTIT

1.	Emri i Subjektit	
2.	Data e Fillimit të aktivitetit	
3.	Lloji i aktivitetit ekonomik	
4.	Adresa - Qendër (Rrugë, Njësi, Telefon)	
5.	Adresa të tjera - Filiale (Rrugë, Njësi, Telefon)	
6.	Përfaqësuesi i subjektit (emër, atësia, mbiemri)	
7.	NUIS - QKR (Nr Unik i Identifikimit)	
8.	Tipi i Pronësisë	Tipi i Subjektit

LISTË VERIFIKIMI PËR "Inspektim i institucioneve arsimore publike parauniversitare (IAP), për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimorë në institucionet e arsimit parauniversitar"

Subjekti:

Nr.NIPT:

Adresa:

Administratori:

Drejtori i shkollës:

Tel/Cel:

Fax:

E-mail:

Lloji Aktivitetit:(Kopsht/AB/AML)

Në zbatim të ligjit/ve nr.

datë

Për

VKM/ve nr.

datë

Për

BAZA LIGJORE

- Ligji nr. 69, datë 21.06.2012, “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Rregullore për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, miratuar me urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020.
- Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimorë në institucionet e arsimit parauniversitar”.
- Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar me nr.4699/1 prot., datë 30.04.2019.

Nr .	Baza Ligjore	Pyetje	Vlerësimi (Po/Jo/Nuk Aplikohet)	Komente
---------	--------------	--------	---------------------------------------	---------

Nr	Baza Ligjore	Pyetje	Vlerësimi (Po/Jo/Nuk Aplikohet)	Komente
1	Gërma a, pika 2, neni 43, Urdhri nr.31, datë 28.01.2020.	A është këshilluar drejtori me këshillin e mësuesve për formimin dhe ndarjen e klasave?		
2	Gërma a, pika 1, kreu I, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A janë formuar grupet e veçanta të nxënësve në kopshtet me ushqim në zonat urbane me jo më pak se 25 nxënës që frekuentojnë?		
3	Gërma b, pika 1, kreu I, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A janë formuar grupet e veçanta të nxënësve në kopshtet e zonave rurale me jo më pak se 15 nxënës që frekuentojnë?		
4	Gërma c, pika 1, kreu I, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A janë formuar grupet e përziera të nxënësve në zonat rurale me jo më pak se 10 nxënës që frekuentojnë?		
5	Gërma c, pika 1, kreu I, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A është formuar grup me jo më pak se 5 nxënës që frekuentojnë kopshtet, në rastet kur ky numër nxënësish nuk është siguruar, pas mendimit pozitiv të njëjësive të vetqeverisjes vendore?		
6	Gërma d, pika 1, kreu I, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A funksionojnë klasat përgatitore në kopshte ose shkolla të arsimit bazë dhe a frekuentohen nga nxënës 5 vjeç që nuk kanë ndjekur arsimin parashkollor?		
7	Gërma d, pika 1, kreu I, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A është formuar klasa përgatitore në zonat urbane me jo më pak se 25 nxënës, ndërsa në zonat rurale me jo më pak se 10 nxënës?		
8	Gërma a, pika 2, kreu I, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A ka kopshti me ushqim ose pa ushqim, që ka të paktën 4 grupe të veçanta ose të përziera, një drejtues të institucionit arsimor?		
9	Gërma b, pika 2, kreu I, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A kanë emëruar njësitë e vetqeverisjes vendore, për kopshtin që veprimtarinë e tij e zhvillon pranë shkollave 9-vjeçare, një drejtues kopshti për jo më pak se 5 grupe nxënësish?		
10	Gërma a, pika 3, kreu I, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A ka drejtori i kopshtit ngarkesë mësimore 18 orë në javë?		
11	Gërma b, pika 3, kreu I, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A ka drejtori i kopshtit, i përcaktuar në pikën 2/b të këtij kreu, ngarkesë mësimore 15 orë në javë.		

Nr	Baza Ligjore	Pyetje	Vlerësimi (Po/Jo/Nuk Aplikohet)	Komente
12	Gërma c, pika 3, kreu I, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A ka mësuesi i arsimit parashkollor ngarkesë mësimore 30 orë në javë?		
13	Pika 4, kreu I, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A ka drejtori i kopshtit ngarkesë 6 orë në javë për procesin e vlerësimit?		
14	Gërma a, pika 1, kreu II, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A janë formuar në arsimin bazë, klasat e veçanta në zonat me jo më pak se 15 nxënës dhe në zonat rurale me jo më pak se 10 nxënës?		
15	Gërma b/i, pika 1, kreu II, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A janë formuar në arsimin bazë dy klasa paralele, për 30-59 nxënës?		
16	Gërma b/ii, pika 1, kreu II, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A janë formuar në arsimin bazë, tri klasa paralele, për 60-99 nxënës?		
17	Gërma b/iii, pika 1, kreu II, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A janë formuar në arsimin bazë, katër klasa paralele, për 100-133 nxënës?		
18	Gërma b/iv, pika 1, kreu II, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A janë formuar në arsimin bazë, pesë klasa paralele, për 134-167 nxënës?		
19	Gërma c, pika 1, kreu II, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A është bërë në arsimin bazë, ndarja e nxënësve në më shumë se pesë klasa paralele për çdo rritje të numrit me 33 nxënës?		
20	Gërma d, pika 1, kreu II, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A është llogaritur në arsimin bazë, numri i punonjësve mësimorë në arsimin fillor një mësues për çdo klasë?		
21	Gërma d, pika 1, kreu II, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A zhvillohen lëndët TIK, Gjuhë e huaj dhe Edukimi fizik, sporti dhe shëndeti (1 orë) nga punonjësit mësimorë të arsimit të mesëm të ulët, sipas profilit përkatës?		
22	Gërma a/1, pika 2, kreu II, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A është formuar në arsimin fillor, një klasë e bashkuar, kur numri i nxënësve në klasat I-V është deri në 10?		
23	Gërma a/ii, pika 2, kreu II, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A janë formuar në arsimin fillor, dy klasa të bashkuara, kur numri i nxënësve është 11–20?		
24	Gërma a/iii, pika 2, kreu II, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A janë formuar në arsimin fillor, tri klasa të bashkuara, kur numri i nxënësve është 21–50?		

Nr	Baza Ligjore	Pyetje	Vlerësimi (Po/Jo/Nuk Aplikohet)	Komente
25	Gërma a/iv, pika 2, kreu II, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A janë formuar në arsimin fillor, klasa të veçanta, kur numri i nxënësve i të gjitha klasave I–V është mbi 50, pavarësisht nga numri i nxënësve për klasë?		
26	Gërma b/i, pika 2, kreu II, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A është formuar në arsimin e mesëm të ulët një klasë e bashkuar, kur numri i nxënësve në klasat VI-IX është deri në 10?		
27	Gërma b/ii, pika 2, kreu II, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A janë formuar në arsimin e mesëm të ulët dy klasa të bashkuara, kur numri i nxënësve është 11-20?		
28	Gërma b/iii, pika 2, kreu II, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A janë formuar në arsimin e mesëm të ulët tri klasa të bashkuara, kur numri i nxënësve është 21-40?		
29	Gërma b/iv, pika 2, kreu II, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A janë formuar në arsimin e mesëm të ulët klasa të veçanta, kur numri i nxënësve i të gjitha klasave VI-IX është mbi 40, pavarësisht nga numri i nxënësve për klasë?		
30	Gërma b/v, pika 2, kreu II, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A zhvillohet mësimi në klasat bashkuara, kur ka më shumë se 10 nxënës, i ndarë vetëm për lëndët Gjuhë shqipe, Gjuhë e huaj dhe Matematikë?		
31	Gërma b/vi, pika 2, kreu II, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A zhvillohet mësimi në klasat I-IX të pakicave kombëtare në klasa të veçanta, pavarësisht numrit të nxënësve për klasë?		
32	Gërma a, pika 3, kreu II, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A është emëruar një drejtor shkolle në arsimin bazë, kur numri i nxënësve është më shumë se 80?		
33	Gërma b, pika 3, kreu II, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A është emëruar një nëndrejtor shkolle në arsimin bazë, kur numri i nxënësve është 200-480?		
34	Gërma c, pika 3, kreu II, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A janë emëruar dy nëndrejtorë shkolle në arsimin bazë, kur numri i nxënësve është 481–800?		
35	Gërma d, pika 3, kreu II, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A janë emëruar tre nëndrejtorë shkolle në arsimin bazë, kur numri i nxënësve është mbi 800?		
36	Gërma e, pika 3, kreu II, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A është emëruar një nëndrejtor në arsimin bazë, kur numri i nxënësve është mbi 150 dhe drejtorja ka në vartësi 4 shkolla?		

Nr	Baza Ligjore	Pyetje	Vlerësimi (Po/Jo/Nuk Aplikohet)	Komente
37	Gërma e, pika 3, kreu II, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A është caktuar një kryemësues kur numri i nxënësve të një shkolle vartëse është më pak se 80 dhe aty punojnë të paktën 4 mësues?		
38	Gërma e, pika 3, kreu II, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A është llogaritur numri i nxënësve të kopshteve që zhvillojnë veprimtarinë e tyre pranë shkollave dhe nuk administrohen nga drejtues kopshti, në numrin e përgjithshëm të nxënësve të shkollës?		
39	Gërma b, pika 4, kreu II, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A e kanë mësuesi/kryemësuesi në arsimin fillor normën javore aq orë mësimore sa janë në planin mësimor të klasës ku jep mësim?		
40	Gërma c, pika 4, kreu II, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A ka mësuesi i gjuhës shqipe, i gjuhës së huaj, i matematikës, i fizikës, i biologjisë, i kimisë, i informatikës, i historisë, i gjeografisë, i teknologjisë, i shkencave shoqërore, mësuesi ndihmës, mësuesi në shkollat e arsimit special, normë mësimore 20 orë në javë?		
41	Gërma d, pika 4, kreu II, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A ka mësuesi i lëndëve të tjera në arsimin bazë normë mësimore 22 orë në javë?		
42	Gërma e, pika 4, kreu II, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A ka kryemësuesi në arsimin e mesëm të ulët normë mësimore 20 orë në javë (përgjigjet për disiplinën dhe inventarin e shkollës)?		
43	Gërma f, pika 4, kreu II, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A e ka drejtori i shkollës në arsimin bazë me 81–300 nxënës normën mësimore 6 orë në javë?		
44	Gërma g, pika 4, kreu II, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A e ka drejtori i shkollës në arsimin bazë me 301–600 nxënës normën mësimore 4 orë në javë?		
45	Gërma h, pika 4, kreu II, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A e ka drejtori i shkollës në arsimin bazë me 601–800 nxënës normën mësimore 2 orë në javë?		
46	Gërma i, pika 4, kreu II, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A e ka drejtori i shkollës në arsimin bazë mbi 800 nxënës normën mësimore 0–2 orë në javë?		
47	Gërma j, pika 4, kreu II, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A e ka nëndrejtori i shkollës në arsimin bazë normën mësimore 6 orë në javë?		

Nr	Baza Ligjore	Pyetje	Vlerësimi (Po/Jo/Nuk Aplikohet)	Komente
48	Gërma j, pika 4, kreu II, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A e plotësojnë drejtori dhe nëndrejtorët e shkollës në arsimin bazë normën mësimore javore vetëm me orë të profilit të diplomës që zotërojnë?		
49	Gërma j, pika 4, kreu II, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A janë ngarkuar nëndrejtori/nëndrejtorët për amzën, inventarin e shkollës dhe Sistemin e Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar në shkollë?		
50	Gërma a, pika 5, kreu II, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A e ka drejtori i shkollës në arsimin bazë me 81–800 nxënës normën e vlerësimit të arritjeve 4 orë në javë (3 orë për vlerësim të cilësisë së procesit mësimor dhe 1 orë për dokumentacionin shkollor)?		
51	Gërma b, pika 5, kreu II, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A e ka drejtori i shkollës në arsimin bazë me mbi 800 nxënës normën e vlerësimit të arritjeve 3 orë në javë (2 orë për vlerësim të cilësisë së procesit mësimor dhe 1 orë për dokumentacionin shkollor)?		
52	Gërma c, pika 5, kreu II, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A e ka nëndrejtori i shkollës në arsimin bazë normën e vlerësimit të arritjeve 4 orë në javë (3 orë për vlerësim të cilësisë së procesit mësimor dhe 1 orë për dokumentacionin shkollor)?		
53	Gërma a, pika 1, kreu III, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A janë formuar në AML, klasat në zonat urbane me jo më pak se 15 nxënës dhe në zonat rurale me jo më pak se 10 nxënës?		
54	Gërma b/i, pika 1, kreu III, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A janë formuar në AML, dy klasa paralele, kur numri i nxënësve është 30-59 nxënës?		
55	Gërma b/ii, pika 1, kreu III, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A janë formuar në AML, tri klasa paralele, kur numri i nxënësve është 60-99 nxënës?		
56	Gërma b/iii, pika 1, kreu III, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A janë formuar në AML, katër klasa paralele, kur numri i nxënësve është 100-133 nxënës?		
57	Gërma b/iv, pika 1, kreu III, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A janë formuar në AML, pesë klasa paralele, kur numri i nxënësve është 134-167 nxënës?		
58	Gërma b/v, pika 1, kreu III, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A është bërë ndarja e nxënësve në më shumë se pesë klasa paralele për çdo rritje të numrit me 33 nxënës?		

Nr	Baza Ligjore	Pyetje	Vlerësimi (Po/Jo/Nuk Aplikohet)	Komente
59	Gërma a, pika 2, kreu III, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A është emëruar në AML, me mbi 80 nxënës, një drejtor shkolle?		
60	Gërma b, pika 2, kreu III, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A është emëruar në AML, me 200-480 nxënës, një nëndrejtor shkolle?		
61	Gërma c, pika 2, kreu III, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A janë emëruar në AML, me 481-800 nxënës, dy nëndrejtorë shkolle?		
62	Gërma d, pika 2, kreu III, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A janë emëruar në AML, me mbi 800 nxënës, tre nëndrejtorë shkolle?		
63	Gërma a, pika 3, kreu III, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A është në AML, norma mësimore javore e mësuesit të gjuhës shqipe dhe i letërsisë 18 orë në javë?		
64	Gërma b, pika 3, kreu III, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A është në AML, norma mësimore javore e mësuesit të gjuhës së huaj, matematikës, fizikës, biologjisë, kimisë, informatikës, historisë, gjeografisë, teknologjisë, shkencave shoqërore (filozofi, psikologji, qytetari, sociologji), ekonomisë, mësuesit ndihmës, mësuesit në shkollat e arsimit special 20 orë në javë?		
65	Gërma c, pika 3, kreu III, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A është në AML, norma mësimore javore e mësuesit të lëndëve të tjera 22 orë në javë?		
66	Gërma d, pika 3, kreu III, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A është në AML, norma mësimore javore e drejtorit të shkollës me 81–300 nxënës 6 orë në javë?		
67	Gërma e, pika 3, kreu III, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A është në AML, norma mësimore javore e drejtorit të shkollës me 301-600 nxënës 4 orë në javë?		
68	Gërma f, pika 3, kreu III, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A është në AML, norma mësimore javore e drejtorit të shkollës me 601-800 nxënës 2 orë në javë?		
69	Gërma g, pika 3, kreu III, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A është në AML, norma mësimore javore e drejtorit të shkollës mbi 800 nxënës 0-2 orë në javë?		
70	Gërma h, pika 3, kreu III, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A është në AML, norma mësimore javore e nëndrejtorit të shkollës 6 orë në javë?		

Nr	Baza Ligjore	Pyetje	Vlerësimi (Po/Jo/Nuk Aplikohet)	Komente
71	Gërma h, pika 3, kreu III, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A e plotësojnë drejtori dhe nëndrejtorët e shkollës normën e tyre mësimore javore vetëm me orë të profilit të diplomës që zotërojnë?		
72	Gërma h, pika 3, kreu III, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A janë ngarkuar nëndrejtori/nëndrejtorët për amzën, inventarin e shkollës dhe Sistemin e Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar në shkollë, kur shkolla nuk ka sekretar?		
73	Gërma a, pika 4, kreu III, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A është në AML, norma e vlerësimit të arritjeve të drejtorit të shkollës me 81-800 nxënës 4 orë në javë (3 orë për vlerësim të cilësisë së procesit mësimor dhe 1 orë për dokumentacionin shkollor)?		
74	Gërma b, pika 4, kreu III, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A është në AML, norma e vlerësimit të arritjeve të drejtorit të shkollës me mbi 800 nxënës 3 orë në javë (2 orë për vlerësim të cilësisë së procesit mësimor dhe 1 orë për dokumentacionin shkollor)?		
75	Gërma c, pika 4, kreu III, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A është në AML, norma e vlerësimit të arritjeve të nëndrejtorit të shkollës 4 orë në javë (3 orë për vlerësim të cilësisë së procesit mësimor dhe 1 orë për dokumentacionin shkollor)?		
76	Pika 1, kreu V, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A përfshin ngarkesa mësimore javore orët e mësimit të çdo lënde që përmban plani mësimor dhe çdo orë të përcaktuar në këtë udhëzim?		
77	Pika 1, Neni 57, Kreu IX, Ligji 69/12 (# me 48/18)	A e ka fituar mësuesi për arsimin parashkollor diplomën e ciklit të parë “Bachelor”, që formon mësues të arsimit parashkollor?		
78	Pika 2, Neni 57, Kreu IX, Ligji 69/12 (# me 48/18)	A e ka fituar mësuesi arsimit fillor diplomën e ciklit të parë “Bachelor” dhe diplomë të ciklit të dytë “Master Profesional” që formon mësues të arsimit fillor, ose diplomë për arsimin fillor të ish-instituteve të larta pedagogjike?		

Nr .	Baza Ligjore	Pyetje	Vlerësimi (Po/Jo/Nuk Aplikohet)	Komente
79	Pika 3, Neni 57, Kreu IX, Ligji 69/12 (# me 48/18)	A ka fituar mësuesi i arsimit të mesëm të ulët dhe i arsimit të mesëm të lartë diplomë të ciklit të parë “Bachelor” në fushën/lëndët e arsimit të mesëm të ulët; të arsimit të mesëm të lartë dhe diplomë të ciklit të dytë “Master” me 120 ECTS në fushën e mësuesisë, që lidhet me programin e studimit të ciklit të parë?		
80	Pika 4, Neni 57, Kreu IX, Ligji 69/12 (# me 48/18)	A e ushtrojnë profesionin e mësuesit edhe individë që zotërojnë diplomë universitare të ciklit të parë dhe të dytë ose diplomë universitare të integruar, të ngjashme ose të përafërt me fushën/lëndët e mësimit në arsimin parauniversitar, dhe njohuri të certifikuar në formimin psikopedagogjik nga institucione të arsimit të lartë, që ofrojnë programe të studimeve të formimit të vazhduar?		
81	Pika 5, Neni 57, Kreu IX, Ligji 69/12 (# me 48/18)	A e ushtron mësuesi i arsimit fillor, i arsimit të mesëm të ulët dhe i arsimit të mesëm të lartë, mësuesi i shkollave të arsimit të orientuar, mësuesi i kulturës së përgjithshme në shkollat profesionale, mësuesi që punon me nxënësit me aftësi të kufizuara dhe mësuesi me diplomë të ngjashme ose të përafërt me diplomat në fushat/lëndët e mësimit në arsimin parauniversitar, profesionin, pasi ka kryer me sukses praktikën profesionale?		

Nr	Baza Ligjore	Pyetje	Vlerësimi (Po/Jo/Nuk Aplikohet)	Komente
82	Germa b, Pika 5, Neni 57, Kreu IX, Ligji 69/12 (# me 48/18)	A e ushtron profesionin mësuesi i arsimit fillor, i arsimit të mesëm të ulët dhe i arsimit të mesëm të lartë, mësuesi i shkollave të arsimit të orientuar, mësuesi i kulturës së përgjithshme në shkollat profesionale, mësuesi që punon me nxënësit me aftësi të kufizuara dhe mësuesi me diplomë të ngjashme ose të përafërt me diplomat në fushat/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar, pasi ka kaluar me sukses provimin e shtetit në fushën e formimit të tij, siç parashikohet në ligjin nr. 10 171, datë 22.10.2009, “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij”?		
83	Pika 2, kreu V, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A e plotëson mësuesi i arsimit parauniversitar normën mësimore javore me lëndë të profilit të tij? (Kur nuk ka orë të mjaftueshme në profilin e tij, mësuesi është ngarkuar me orë mësimore të profileve të përafërta, sipas shtojcës 1 bashkëlidhur dhe pjesë e këtij udhëzimi.)		
84	Germa b, pika 2, neni 43, kreu X, Rregullorja e IAP-së, urdhri nr. 31, datë 28.01.2020	A ka caktuar drejtori IA-së, pas këshillimit me këshillin e mësuesve, ngarkesën mësimore të mësuesve dhe a ka marrë miratimin e ZVA-së për këtë ndarje?		
85	Pika 3, kreu V, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A ka shpërndarë ngarkesën mësimore sipas profileve dhe a ka përcaktuar mësuesit që mbeten pa ngarkesë mësimore drejtorja e shkollës në AML, duke plotësuar së pari me orë mësimore mësuesit që janë diplomuar në lëndën/profilin që është shkruar i pari në kolonën e profileve të kërkuara, në shtojcën 1, të këtij udhëzimi?		
86	Pika 4, kreu V, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A është bërë në shkollat e arsimit bazë, shpërndarja dhe planifikimi i ngarkesës mësimore për të gjitha profilet në mënyrë të njëjtë, pa marrë në konsideratë radhën në të cilën ato janë shkruar në kolonën e profileve të kërkuara në shtojcën 1?		

Nr	Baza Ligjore	Pyetje	Vlerësimi (Po/Jo/Nuk Aplikohet)	Komente
87	Pika 5, kreu V, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A i janë llogaritur mësuesit që mentoron praktikën profesionale të kandidatëve për mësues, dy orë mësimore në javë si orë mbi normë/ngarkesë për periudhën e mentorimit?		
88	Pika 6, kreu V, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A i janë llogaritur mësuesit që përgatit nxënës për fazën e dytë dhe të tretë të olimpiadave, ose për pjesëmarrje në konkurse kombëtare dhe ndërkombëtare, dy orë mësimore në javë si orë mbi normë/ngarkesë për periudhën e angazhimit?		
89	Pika 7, kreu V, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A janë vlerësuar të gjitha normat e veçanta, të përcaktuara në këtë kre për efekte financiare në vlerën e orës mësimore?		
90	Pika 8, kreu V, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A është barasvlerësuar puna e mësuesit kujdestar (mësuesit të klasës) me 2 orë mësimore në javë?		
91	Pika 9, kreu V, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A bëhet masa e pagesës për orën mësimore mbi ngarkesën mësimore javore sipas tarifave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave?		
92	Pika 10, kreu V, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A paguhet çdo orë mësimore e realizuar nga mësuesi mbi ngarkesën mësimore javore si orë mbi normë, në fund të çdo muaji?		
93	Pika 11, kreu V, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A përgjigjet kryemësuesi në një shkollë vartëse të arsimit bazë me të paktën 4 mësues, për disiplinën dhe inventarin e shkollës?		
94	Pika 12, kreu V, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A i llogariten dhe a i paguhen mësuesit/kryemësuesit në arsimin fillor, kur klasa e bashkuar ka mbi 10 nxënës, 5 orë mbi normë/ngarkesë për çdo javë mësimi të zhvilluar?		
95	Pika 13, kreu V, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A ka mësuesi në arsimin e mesëm të ulët dhe në arsimin e mesëm të lartë, orë mbi normë/ngarkesë jo më shumë se 30% të ngarkesës mësimore javore?		
96	Pika 14/a, kreu V, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A i llogariten mësuesit që drejton bibliotekën e shkollës 2 orë në javë, kur shkolla ka bibliotekë dhe ka deri në 300 nxënës?		

Nr	Baza Ligjore	Pyetje	Vlerësimi (Po/Jo/Nuk Aplikohet)	Komente
97	Pika 14/b, kreu V, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A i llogariten mësuesit, që drejton bibliotekën e shkollës, 3 orë në javë, kur shkolla ka bibliotekë dhe ka mbi 301–600 nxënës?		
98	Pika 14/c, kreu V, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A i llogariten mësuesit, që drejton bibliotekën e shkollës, 4 orë në javë, kur shkolla ka bibliotekë dhe ka mbi 600 nxënës?		
99	Pika 15, kreu V, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A janë llogaritur për zhvillimin e veprimtarive konkrete të programuara në kuadër të shkollës si qendër komunitare 10 orë në javë, të ndara me jo më shumë se 2 orë për mësues?		
100	Pika 16, kreu V, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A i janë llogaritur mësuesit që drejton rrjetin profesional (në arsimin parashkollor, arsimin bazë dhe arsimin e mesëm të lartë), 2 orë mësimore në javë?		
101	Pika 17, kreu V, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A i janë llogaritur mësuesit që merret me veprimtaritë artistike dhe mësuesit që kryen detyrën e koordinatorit të qeverisë së nxënësve për shkollat nën 700 nxënës secilit 2 orë në javë dhe për shkollat mbi 700 nxënës i janë llogaritur secilit 4 orë në javë?		
102	Pika 18, kreu V, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A është barasvlerësuar për zhvillimin e veprimtarive të miratuara në kuadër të nismës “Bëjmë detyrat e shtëpisë” (BDSH), ora e studimit me orën mësimore?		
103	Pika 18, kreu V, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A realizohen në çdo institucion arsimor të përfshirë në këtë nismë jo më shumë se 3 orë studimi në ditë për çdo klasë të krijuar?		
104	Pika 18, kreu V, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A e plotëson një mësues ngarkesën mësimore javore me jo më shumë se 3 orë studimi BDSH?		
105	Pika 19, kreu V, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A i është ulur ngarkesa mësimore javore mësuesit, në shkollat me më shumë se 700 nxënës që kanë palestër, kur krijojnë dhe stërvitin ekipe sportive, jo më shumë se në dy lloje sporti për femra dhe meshkuj, me 3 orë në javë?		

Nr .	Baza Ligjore	Pyetje	Vlerësimi (Po/Jo/Nuk Aplikohet)	Komente
10 6	Pika 20, kreu V, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A i janë llogaritur si ngarkesë mësimore mësuesit të specialitetit në shkollat sportive, kur stërvi grupet/ekipet sportive të shkollës për pjesëmarrje në takimet sportive (kampionate rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare), sipas kalendarëve sportivë të federatave shqiptare përkatëse, në përmbushje të veprimtarive sportive të parashikuara në kurrikulën sportive, 3 orë në javë?		
10 7	Pika 21/a, kreu V, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A zhvillohet mësimi në lëndën e edukimit fizik i ndarë sipas gjinisë dhe, kur është e mundur, mësuesi a është i së njëjtës gjini me nxënësit?		
10 8	Pika 21/a, kreu V, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A bëhet mësimi i edukimit fizik në arsimin e mesëm të ulët dhe atë të mesëm të lartë, kur numri i nxënësve për çdo gjini është jo më pak se 10 nxënës, i ndarë në gjini?		
10 9	Pika 21/b, kreu V, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A bëhet mësimi i edukimit fizik në arsimin e mesëm të ulët dhe atë të mesëm të lartë që kanë klasa paralele, kur numri i nxënësve për çdo gjini në të paktën një paralel, është më i vogël se 10 nxënës, i ndarë në gjini, por duke bashkuar dy paralele?		
11 0	Pika 21/c, kreu V, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A bëhet mësimi i edukimit fizik në arsimin e mesëm të ulët dhe atë të mesëm të lartë që nuk kanë klasa paralele, kur numri i nxënësve për çdo gjini është më i vogël se 10, pa u ndarë në gjini?		
11 1	Pika 24, kreu V, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A u llogaritet mësuesve që vlerësojnë testet e provimeve kombëtare të arsimit bazë, për efekt pagese 1 orë mësimore për 3 teste të vlerësuara?		
11 2	Pika 25, kreu V, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A u llogaritet mësuesve që vlerësojnë fazën II të olimpiadave kombëtare të organizuara nga ministria përgjegjëse për arsimin, për efekt pagese 1 orë mësimore për 3 teste të vlerësuara?		
11 3	Pika 26, kreu V, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A i është ulur norma nëndrejtorit të ngarkuar për plotësimin e amzës së shkollës, ose si administrator për Sistemin e Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar në shkollë, me 2 orë mësimore në javë?		

Nr .	Baza Ligjore	Pyetje	Vlerësimi (Po/Jo/Nuk Aplikohet)	Komente
11 4	Pika 27, kreu V, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A është ngarkuar një mësues në shkollat që nuk kanë as nëndrejtor, as sekretar, për plotësimin e amzës së shkollës, si dhe një mësues për Sistemin e Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar në shkollë, të cilëve u është ulur ngarkesa me 2 orë mësimore në javë?		
11 5	Pika 28, kreu V, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A zhvillohen në klasën e dymbëdhjetë të gjimnazit, lëndët me zgjedhje në bazë të kërkesave të nxënësve për një lëndë të caktuar?		
11 6	Pika 29, kreu V, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A janë ngarkuar si rregull, mësuesit të cilëve u është ulur ngarkesa për kryerjen e veprimtarive të ndryshme të përcaktuara në këtë udhëzim, me orë shtesë të pagueshme, përveç rasteve kur shkolla në bashkëpunim me institucionin arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, nuk mund t'i mbulojë ato orë me mësues të tjerë?		
11 7	Pika 30, kreu V, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A i është ulur norma mësuesit mbikëqyrës të procesit të Maturës Shtetërore me 2 orë mësimore në javë?		
11 8	Pika 31, kreu V, Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023	A paguhet mësuesi që në kuadër të Maturës Shtetërore, në gjimnazin e caktuar nga institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, ngarkohet për hedhjen e notave të të gjitha viteve të kandidatëve me diplomë të shkollës së mesme të fituar jashtë shtetit dhe të njësuar në Shqipëri, jo më shumë se 30 orë mbi normë/ngarkesë në vit?		
11 9	Gërma f, neni 16, Kreu II, të Rregullore për organizimin e DPAP nr.4699/1 prot., datë 30.04.2019, dhe Pika 5, neni 106, kreu XVIII, Rregullorja e IAP-së, urdhri 31, datë 28.01.2020.	A propozon grupi i inspektimit për masë disiplinore ndaj drejtuesit të IAP-së për shkeljet e konstatuara?		

Nr .	Baza Ligjore	Pyetje	Vlerësimi (Po/Jo/Nuk Aplikohet)	Komente
120	Germa a, Pika 1, Neni 71, Kreu XIII, Ligji 69/12 (# me 44/23)	A konsiderohet kundërvajtje administrative e drejtorit të institucionit arsimor publik shkelja e kërkesave ligjore për veprimtarinë e institucioneve arsimore publike, që konstatohet dhe dënohet nga inspektori i autorizuar nga institucioni përgjegjës për ofrimin dhe sigurimin e shërbimit arsimor, sipas legjislacionit për inspektimin me dënimin administrative kryesor “paralajmërim”?		
121	Germa b, Pika 1, Neni 71, Kreu XIII, Ligji 69/12 (# me 44/23)	A konsiderohet kundërvajtje administrative e drejtorit të institucionit arsimor publik shkelja e kërkesave ligjore për veprimtarinë e institucioneve arsimore publike, që konstatohet dhe dënohet nga inspektori i autorizuar nga institucioni përgjegjës për ofrimin dhe sigurimin e shërbimit arsimor, sipas legjislacionit për inspektimin me dënimin administrativ kryesor “gjobë, në vlerën e gjysmës së pagës mujore”?		
122	Pika 2, Neni 71, Kreu XIII, Ligji 69/12.	A vendos inspektori i autorizuar nga institucioni përgjegjës për ofrimin dhe sigurimin e shërbimit arsimor në arsimin parauniversitar që dënimi administrativ kryesor, sipas pikës 1, të këtij neni, të shoqërohet me urdhërimin e subjektit të inspektimit për të korrigjuar shkeljet e konstatuara dhe eliminuar pasojat e tyre, duke përcaktuar edhe një afat të arsyeshëm për këtë qëllim?		
123	Germa b, neni 16, Kreu II, të Rregullore për organizimin e DPAP nr.4699/1 prot., datë 30.04.2019.	A jep grupi i inspektimit rekomandimet përkatëse për shkeljet e konstatuara?		

* Shënim sqarues:

1. Gjatë hartimit të pyetjeve, ISH duhet të kenë parasyshë se: vlerësimi “po” është plotësim i kërkesës ligjore, ndërsa vlerësimi “jo” është shkelje e kërkesës ligjore.

Këto vlerësime ndikojnë drejtpërdrejtë në modulën e riskut dhe kategorizimin e subjekteve në bazë risku.

2. Në këtë format mund të shtohen të dhëna të tjera të domosdoshme të kërkuara nga inspektoratet shtetërore pas miratimit nga IQ.

INSPEKTORËT